

URDHËR
Nr. 279, datë 25.4.2020

PËR LEHTËSIMIN E POSATÇËM TË LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA”

(ndryshuar me urdhrin nr. 288, datë 30.4.2020; nr. 304, datë 8.5.2020; nr. 328, datë 18.5.2020)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, vendimit të Komitetit Teknik nr. 1892/1, datë 24.4.2020,

URDHËROJ:

1. Caktimin e qarkut Dibër, qarkut Gjirokastrë, zonës së përbashkët të bashkive Sarandë, Konispol, Himarë, Delvinë dhe Finiq, zonës së përbashkët të bashkive Përrenjas, Pogradec dhe Librazhd dhe Bashkia Divjakë *Belsh, Cërrik, Gramsh, Kucovë, Berat, Tropojë, Maliq, Devoll, Kolonjë, Ura Vajgurore, Mallakastër, Rrogozhinë, Pustec, Skrapar, Polican, Selenicë, Vlorë, Lushnjë, Patos, Roskovec, Korçë, Has, Kukës, Lezhë, Mirditë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Vau i Dejës, Kavajë, Vorë, Rrogozhinë, Peqin, Fier* “zona të gjelbërta”, apo zona me rrezik të ulët të transmetimit të infeksionit nga COVID-19.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Ndalohet lëvizja dhe qëndrimi në një vend i më shumë se dy personave. Parqet publike dhe hapësirat e gjelbërta të rrethuara do të vazhdojnë të jenë të mbyllura edhe në këto zona për 14 ditë.

5. Mjetet e transportit të punonjësve në institucionet publike dhe/ose private do të lejohen të lëvizin me autorizimin përkatës, sipas orarit të diktuar nga natyra e punës vetëm me një pasagjer i cili duhet të ulet në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit, sipas protokolleve të miratuara.

6. *Lejohet lëvizja e mjeteve private, pa autorizim, vetëm brenda qarkut ose bashkisë së zonave të gjelbërta, vetëm me pasagjer anëtarët e familjes.*

6/1 Shfuqizuar.

7. Ndalohet lëvizja e pensionistëve me mjete private ose marrja e tyre si pasagjerë me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu